

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC)

Në qytetin e Korçës ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 30 organizata të shoqërisë civile, të cilat zbatojnë projekte në fusha të ndryshme.

Bashkia Korçë në bashkëpunim me UNDP dhe programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara “ReLOaD”, ka ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe mundësi bashkëpunimi për realizim projektesh apo iniciativash të përbashkëta me Organizatat e Shoqërisë Civile.

Forma e dhënies së mbështetjes financiare për OSHC-të bazohet në “Metodologjine LOD”, dokument i cili është përgatitur në kuadër të zbatimit të Projektit “ReLOaD”, i cili ka për qëllim për forcimin e demokracisë vendore të zbatuar në Bosnjë dhe Hercegovinë, zbatuar nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP).

Gjatë 3 Thirrjeve Publike të zhvilluara nga Bashkia Korçë për periudhën 2017- 2022, Bashkia Korçë në bashkëpunim me UNDP ka mbështetur për zbatimin e projekteve 6 organizata, të cilat kanë zbatuar projektet e tyre brenda territorit të Bashkisë Korçë dhe pasur në fokus të tyre forcimin e demokracisë vendore, zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, mjedisit, përfshirjen sociale të grupeve në nevojë, etj.

Për vitin 2023, bazuar në thirrjen publike të Reload2 është mbështetur me fond nga Bashkia një organizatë fituese, nga tre aplikime gjithsej të dorëzuara në Bashkinë Korçë. Organizata fituese është duke zbatuar për një periudhë 6 mujore, projektin për artin dixhital dhe imersiv në Korçë. Më poshtë gjeni link të shpalljes së thirrjes publike në kuadër të programit ReLOaD2: <https://bashkiakorçe.gov.al/site/search.php?q=reload2>

Komisioni i Vlerësimit është organi përgjegjës për vlerësimin e projekt-propozimeve të dorëzuara nga OSHC-të në bazë të Thirrjeve Publike në Bashkinë Korçë. Pjesë e komisionit të vlerësimit është edhe një përfaqësues i Shoqërisë Civile, i cili zgjidhet me shumicë votash nga OSHC dhe së bashku me përfaqësues të Bashkisë, vlerëson dhe përzgjedh projektet fituese, që do të financohen brenda fondeve të disponueshme për mbështetjen e OSHC. Projektet që kanë fituar numër më të madh të pikëve dhe kanë zbatuar udhëzimet e kërkuara sipas “Metodologjisë LOD” kanë prioritet për t’u përzgjedhur fituese.

Udhëzimet mbi Thirrjet publike si edhe paketa e aplikimit publikohen në mënyrë transparente në rrjetet sociale dhe njoftimit përmes e-mail të OSHC, si edhe prezantohen në detaje edhe gjatë ditëve të hapura (takimeve) të organizuara midis Bashkisë Korçë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile.

Përfituese të mbështetjes jo financiare në qytetin e Korçës kanë qenë të gjitha organizatat lokale si edhe organizata të tjera, të cilat kanë qëllim realizimin e aktiviteteve të tyre në territorin e Bashkisë Korçë. Përmendim angazhimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me organizatat lokale, të cilat kanë qenë dashamirëse dhe tepër bashkëpunues në nisma dhe aktivitete të realizuara përmes bashkëpunimit të ngushtë me Bashkinë.